

KONKLuzionet e dakorduarA – 2 Shtator 2011

ShënimeT kadastrale

1. Me qëllim për të mbrojtur të drejtat e njerëzve me kërkesa legjitime në pronë, palët do të bëjmë çdo përpjekje për të vendosur një kadastrë plotësisht të besueshëm në Kosovë;
2. Një grup trepalësh, i përbërë nga ekspertë kadastralë nga të dyja palët dhe i kryesuar nga BE, do të monitorojë punën e një agjencie teknike (të përzgjedhur pas konsultimeve me të dyja palët), roli i së cilës do të jetë që të identifikojë zbrastësirat në shënimeT kadastrale origjinale të para vitit 1999;
3. Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian (PSBE) do t'i marrë kopjet e të gjitha shënimeve origjinale kadastrale të cilat janë larguar nga Kosova. Sipas kërkesës, PSBE do të ofrojë të dhëna të caktuara nga Kosova.
4. Agjencia teknike, e lartëcekur në pikën 2, do t'i krahasojë të gjitha kopjet e shënimeve kadastrale origjinale të pronës private¹ të para vitit 1999 me kadastrën e rikonstruktuar të Kosovës. Rastet kur krahasimi tregon se shënimeT nuk përputhen do t'i përcillen nga grupi trepalësh një mekanizmi gjyqësor në Kosovë. Ky mekanizëm gjyqësor do të përcaktojë përfundimisht se cilat shënime kadastrale janë të sakta.
5. Shkalla e parë e mekanizmit gjyqësor do të ushtrohet nga një komision i ekspertëve kadastralë dhe pronësorë ndërkombëtarë dhe kosovarë. Shumica e ekspertëve do të emërohen nga PSBE, duke marrë parasysh interesat e të gjitha komuniteteve;
6. Gjykata Supreme e Kosovës do të veprojë si shkallë e dytë e apelit e mekanizmit gjyqësor. Vendimet e Gjykatës Supreme të Kosovës do të merren nga një kolegji i në të cilin shumicën do ta mbajnë gjykatësit ndërkombëtarë dhe do të jenë vendime përfundimtare dhe pa mundësi ankese;
7. Vendimet të cilat dalin nga mekanizmi gjyqësor i lartëcekur do t'u kumtohen të gjitha palëve të interesuara. Agjencia Kadastrale e Kosovës do t'i zbatojë vendimet përfundimtare që dalin nga mekanizmi gjyqësor i lartëcekur duke i futur ndryshimet e nevojshme në kadastrin e Kosovës;
8. Grupi trepalësh implementues do ta monitorojë zbatimin dhe funksionimin e shpejtë të aranzhmaneve të lartëcekura dhe do ta njoftojë rregullisht Dialogun lidhur me progresin.

¹Kjo do të përfshijë pronën private, private komerciale dhe dokumentacionin kadastral të pronës private të kishës.